

KËRKIME GJUHËSORE

Besnik RAMA

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHTETËRORE (GJUHA, FJALORI DHE STILI)

HYRJE. Matura Shtetërore është kryerja e provimeve me detyrim dhe e provimeve me zgjedhje në përfundim të shkollës së mesme. Për herë të parë, Matura Shtetërore u paraqit në vitin 2006 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke zëvendësuar Provimet e Pjekurisë. Pjesë e Maturës Shtetërore janë edhe shkollat e mesme profesionale. Marrja e provimeve të Maturës Shtetërore nënkupton përfundimin e arsimit të mesëm. Matura Shtetërore është edhe proces i kalimit prej shkollës së mesme në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat.

Matura Shtetërore është një proces i centralizuar. Provimet e Maturës Shtetërore janë provime kombëtare, kryhen në të njëjtën kohë, në kushte të barabarta, sipas procedurave dhe rregullave të njëjta për të gjithë kandidatët, dhe në përputhje me të njëjtat kritere të vlerësimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës bën administrimin e përgjithshëm dhe logjistik të provimeve në të gjithë vendin. AVA (Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve), është përgjegjëse për hartimin dhe përzgjedhjen e testeve, si dhe për caktimin e vlerësuesve kombëtarë. Një agjenci e dytë, APRIAL (Agjencia e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë), është përgjegjëse për pranimin e aplikantëve në të gjitha universitetet shqiptare publike. Duke kaluar provimet e Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje), kandidatët pajisen me diplomë, duke treguar se kanë arritur standardet e njohurive të përcaktuara nga programet e përgjithshme të shkollave të mesme. Pranimi në universitet bëhet sipas parimit Meritë-Preferencë.

Megjithatë, Matura Shtetërore, edhe pse nga viti në vit ka ardhur duke u konsoliduar, nuk u ka shpëtuar kritikave për nivelin jostandard të testeve, për subjektivitet dhe rreptësi apo butësi në vlerësim, për mungesë rregulli në mjedise provimesh etj. Për shembull, në provimin e letërsisë, qershor 2007, vetëm pesëdhjetë maturantë arritën rezultatin më të lartë të mundshëm nga 30.000 në gjithë republikën. Është vërejtur se u morën shumë pak nota pesa (vlerësimi minimal për kalim), ndërkohë që jo pak maturantë dështuan në provim. Notat më të zakonshme ishin 6, 7 dhe 8. Rezultatet e mësipërme nxitën pakënaqësi dhe zemërim në radhët e maturantëve, të cilët u shqetësuan për efektet që mund të kishin këto nota në pranimin e tyre në universitetet brenda e jashtë Shqipërisë.

1. PËR VENDIN QË ESEJA ZË NË TESTIN E MATURËS SHTETËRORE (NJË VËSHTRIM I SHKURTËR)

1.1. Përmbajtja e testeve të gjuhës shqipe dhe letërsisë, 2006-2011.

Thuajse çdo vit, testi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë përmban 25 pyetje, të cilat, në fakt, asnjëherë nuk janë 25, por më shumë, mbi 30, pasi disa prej tyre përmbajnë 2-3 nënkërkesa. P.sh., testi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, drejtimi natyror, i sesionit I, 1 qershor 2011, përmbante gjithsej 37 kërkesa. Pyetjet 1-6 dhe 13-19

(13 pyetje) ishin pyetje që kërkonin përgjigje me zgjedhje (me qarkim), kurse pyetjet e tjera kërkonin përgjigje me zhvillim, ishin pyetje të hapura. Pyetjet 7, 9, 10, 20, 22 dhe 23 përmbanin nga dy kërkesa secila, pyetjet 8, 11, 21 përmbanin nga tri kërkesa secila, ndërsa pyetjet 12, 24 dhe 25 kishin hapësirë për shtjellime, shpjegime e zhvillime më të gjera.¹ Eseja, zakonisht, është kërkesa e fundit në testin e Maturës Shtetërore. Ajo përbën një peshë të konsiderueshme në rezultatin që mund të arrijë maturanti. Në rastin më të mirë, kur eseja e shkruar nga maturanti vlerësohet me 8 pikë, kjo do të thotë se vetëm me përmbyshjen e një kërkesë, është siguruar 16% e vlerësimit maksimal në provimin e detyruar të lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi”.

2. GJUHA, FJALORI DHE STILI

Gjuha e bën esenë të tingëllojë më interesante. Kjo nuk do të thotë që një gjuhë e pëlqyeshme dhe interesante ndërtohet vetëm me fjalë të mëdha. Një gjuhë e përshtatshme në ese përbëhet nga një kombinim i mirë i gramatikës, fjalorit, drejtshkrimit dhe shumëllojshmërisë së fjalive. Ç’do të thotë kjo?

E gjithë përpjekja e maturantit për të organizuar dhe për të korrigjuar gramatikën dhe drejtshkrimin duhet të përdoret për të krijuar një ese me gramatikë të saktë. Përdorimi i fjalëve të mëdha ndonjëherë është ndihmë e vlefshme për të arritur këtë qëllim, por një fjalor i thjeshtë, i përdorur saktë, mund të jetë më mbresëlënës se përdorimi i gabuar i fjalëve komplekse. Një ose dy gabime drejtshkrimore nuk e ndryshojnë vlerësimin, por, megjithatë, mund të ndikojnë vlerësimin holistik (të përgjithshëm) të esesë nga vlerësuesi.

Tri kërkesat madhore² për një ese të suksesshme:

- ✓ Shumëllojshmëria e ideve (kompleksiteti).
- ✓ Shtjellimi i esesë.
- ✓ Përdorimi i gjuhës.

Një listë e plotë vetëvlerësimi që mund ta ndihmonte maturantin:

- A është shprehur qartë pikëpamja?
- A është organizuar mirë eseja?
- A japin hollësi shembujt përkatës?
- A shpjegohet se si shembujt mbështesin tezën e maturantit?
- A ka kalime logjike nga një ide në tjetrën?
- A ka shumëllojshmëri në strukturën e fjalive dhe pasuri fjalori?
- A është përfundimi i mirë?
- A është eseja e lexueshme, e qartë?

Kriteret e vlerësimit të esesë në Maturën Shtetërore

Për vlerësimin e esesë, në Maturën tonë Shtetërore ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË	2 pikë
KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË	2 pikë

¹ Për më shumë detaje e hollësi, shih: “Matura Shtetërore” në faqen elektronike: www.mash.gov.al

² A. Robinson, J. Katzman and the Staff of the Princeton Review, *Cracking the SAT 2010 Edition*, USA, p. 359-380.

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHTETËRORE

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi shikon nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(sintaksa 1 pikë; drejtshkrimi 1 pikë)

Vlerësuesi shikon nëse nxënësi:

- strukturën qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

2.1. DISA TREGUES TË ARRITJEVE TË MATURANTËVE NË ESETË E MATURËS SHTETËRORE

2.1.1. Tregues nga Matura Shtetërore 2008. Në Maturën Shtetërore 2008, “1.04% e nxënësve ndodhen në intervalin 45-50 pikë, 10% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0-10 pikë, 25.83% e nxënësve kanë marrë 0-16 pikë, ndërsa 48.60% kanë marrë 25-49 pikë. Maksimumi i pikëve nuk është arritur nga asnjë nxënësi.”³

“Ashtu si në Maturën 2007, edhe në Maturën 2008, kërkesa/pyetja që ka dhënë ndikimin kryesor në këtë situatë ka qenë eseja, ku përgjigjet e nxënësve janë larg nivelit të pritshmërisë. Ajo ka qenë e tipit krahasues dhe e strukturuar.

Nga analiza e rezultateve për secilën nga kriteret e vlerësimit për këtë kërkesë rezulton se:

- ***në stilin dhe origjinalitetin*** nxënësit kanë shfaqur që zotërojnë një fjalor të varfër dhe se mungon origjinaliteti.

Arsyet e përfundimeve të dhëna më sipër mund të jenë:

- njohje e kufizuar të veprës në përgjithësi (lexojnë vetëm fragmentet e dhëna në tekst);
- niveli i teksteve për nxënësit (ku imponohet më shumë mësimi i fakteve dhe riprodhimi i tyre, si dhe i analizave dhe interpretimeve të gatshme);
- metodologjia e mësimdhënies (aftësia e kufizuar e mësuesve në integrimin e lëndës së gjuhës me letërsinë);
- mungesa e përvojës me pyetjet ese;
- lexim i pakët i veprave;
- punë e pamjaftueshme me detyra specifike (analiza, krahasime, përshkrime argumentive), të cilat krijojnë hap pas hapi një mënyrë personale të shprehuri dhe pasuri fjalori.”⁴

³ Raporte - Matura Shtetërore 2008, Tiranë, 2009, botim i AVA-s, f. 21-22.

⁴ Raporte - Matura Shtetërore 2008, Tiranë, 2009, f. 23-24.

Për testin e drejtimit natyror: “Kërkesa 12c është më e vështirë, pasi mësimdhënia pak ose shumë pak punon me raportet e mendimit të pavarur, argumentues, përshkrues me atë konstatues, ose shpjegues. Natyrisht kjo është e lidhur edhe me njohjen e paktë që jep shkolla kur flitet për mendimin e strukturuar.”⁵

2.1.2. Tregues nga Matura Shtetërore 2009. “Po të krahasojmë mesataren e pikëve në test për tre vitet e fundit konkludojmë se për vitin 2007 mesatarja e pikëve ka qenë 19.73, për vitin 2008 mesatarja e pikëve ka qenë 24.10 dhe për vitin 2009 shohim se është 25.31. pra, në maturën 2009 kemi një rritje të dukshme të mesatares së pikëve të fituara në test.”⁶

“vihet re që nga 9.46% e nxënësve që kanë pasur 10 notën vjetore në lëndën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe vetëm 0.46% e tyre kanë mundur të mbajnë po të njëjtën notë në provimin e Maturës.”⁷

Për testin e drejtimit shoqëror dhe atij të përgjithshëm: “Kërkesë e vështirë rezulton edhe pyetja e hapur 13 (eseja). Ajo ka qenë e tipit argumentuese, e strukturuar... Nga analiza e rezultateve të marra për secilën nga kriteret e vlerësimit, na rezulton se... Për kriterin e tretë të vlerësimit: stili dhe origjinaliteti, sërish kemi rezultate shumë të ulëta. Kështu vetëm 6.61% e popullatës ka arritur të marrë pikët maksimale (2 pikë) dhe 59.11% ka marrë 0 pikë.

...Në lidhje me saktësinë sintaksore dhe drejtshkrimore shikojmë se 19.67% e nxënësve kanë marrë 2 pikë dhe 40% kanë marrë 0 pikë.”⁸

Testi natyror: “... pothuajse 90% e nxënësve kanë arritur të grumbullojnë mbi 22.6% pikë. Duhet theksuar edhe fakti se 1% e nxënësve kanë arritur të grumbullojnë mbi 45.3 pikë.”⁹

Testi i shkollave të mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare. Për esenë: “Rezultatet janë brenda pritshmërisë. Vihet re një dobësi e nxënësve në pikën c, e cila ka të bëjë me realizimin e stilit origjinal në të shprehur. Në punimet me shkrim, defekti i nxënësve tanë sot është i dukshëm pikërisht në këtë pikë, në aftësitë individuale dhe spikatjen origjinale, me fjalë të tjera, në formulimet dhe performancën e formulimit.”¹⁰

Tabelë me të dhëna statistikore për Maturën Shtetërore 2008 (në %)

Testi	c			d		
	0	1	2	0	1	2
Shoqëror dhe i përgjithshëm ¹¹	62.61	31.41	5.98	45.96	37.61	16.42
Natyror ¹²	41.66	52.45	5.89	18.75	53.80	27.45

⁵ Raporte Matura Shtetërore 2008, Tiranë, 2009, faqe 145.

⁶ Raporte Matura Shtetërore 2009, Tiranë, 2010, faqe 7.

⁷ Po aty, faqe 17.

⁸ Raporte - Matura Shtetërore 2009, Tiranë, 2010, f. 112-113.

⁹ Po aty, f. 122.

¹⁰ Po aty, f. 233.

¹¹ Po aty, tabela në f. 112

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHETËRORE

Pedagogjike ¹³	54.03	38.18	7.79	34.97	45.22	19.81
Gjuhët e huaja ¹⁴	32.02	55.79	12.19	15.05	49.10	35.54
Seks. dygjuhësh ¹⁵	84.21	14.17	1.62	67.59	24.43	7.98
Social kulturore... ¹⁶	63.29	33.27	3.44	44.67	42.86	12.48
Tek. profesionale ¹⁷	73.21	23.97	2.82	54.23	36.09	9.69

Tabelë me të dhëna statistikore për Maturën Shtetërore 2009 (në %)

Testi	c			d		
	0	1	2	0	1	2
Shoqëror dhe i përgjithshëm ¹⁸	59.11	34.28	6.61	40.33	19.67	31.27
Natyror ¹⁹	41	52	7	15	61	24
Pedagogjike ²⁰	66	32	2	39	46	15
Gjuhët e huaja ²¹	55	40	5	19	58	23
Seksioni dygjuhësh ²²	21	68	11	2	56	42
Social kulturore... ²³	82	17	1	65	31	4
Tek. profesionale ²⁴	68	31	1	33	55	12

2.2. ARRITJE TË MATURANTËVE NË SAKTËSINË GJUHËSORE, STILIN DHE ORIGINALITETIN

- Maturanti shkruan natyrshëm, pa sforco dhe zotëron artin e ligjërimit me shkrim. Respekton elementet e strukturës së esesë. Eseja ndjek një vijimësi logjike dhe kronologjike, është organizuar shumë mirë dhe me argumente, të cilat mbështeten e trajtohen mirë.
- Teza, argumentet dhe kundërargumentet, mendimet dhe idetë shprehen me fjali të shkurtra të qarta, që përmbajnë fjali me kuptim, fjali të zgjedhura nga fjali që zotëron maturanti;
- Maturanti ka strukturuar të gjitha pjesët e saj përbërëse dhe ka përdorur argumente të qarta dhe bindëse për trajtimin e argumentit. Maturanti me

¹² Po aty, tabela në f. 133.

¹³ Po aty, tabela në f. 153.

¹⁴ Po aty, tabela në f. 175.

¹⁵ Po aty, tabela në f. 196.

¹⁶ Po aty, tabela në f. 216.

¹⁷ Po aty, tabela në f. 236-237.

¹⁸ Raporte - Matura Shtetërore 2009, Tiranë, 2010, tabela në f. 100-101.

¹⁹ Po aty, tabela në f. 122-124.

²⁰ Po aty, tabela në f. 143-145.

²¹ Po aty, tabela në f. 165-166.

²² Po aty, tabela në f. 183-184.

²³ Po aty, tabela në f. 202-205.

²⁴ Po aty, tabela në f. 223-225.

formim të plotë gjuhësor, letrar dhe kulturor. Gjuha është e pasur, e rregullt, e larmishme, e përpunuar dhe e plotë.

- Maturanti shprehet me një gjuhë eseistike që lidh paragrafët në mënyrë unike. Është konciz dhe i saktë në atë që thotë. Tregon për një nxënës që lexon dhe që e ka të përpunuar stilin origjinal me gjuhë dhe mendim të pasur.
- Ka saktësi drejtshkrimore.
- Ka fjalor të pasur, ka stil origjinal, strukturën qartë esenë nga pikëpamja gramatikore.

Ka aftësi të ndërtojë fjali, brenda së cilës variojnë kundërshtitë e mendimit personal. Përdor fjali me gjatësi të ndryshme.

2.3. MANGËSI TË MATURANTËVE NË SAKTËSINË GJUHËSORE, STILIN DHE ORIGJINALITETIN

- Esetë përmbajnë më tepër pohime se trajtime e argumentime.
- Mendimet herë-herë paraqiten të paplota, si: *Se të jetosh do të thotë të shijosh gjithçka, gjithë gëzimet dhe harmonitë që natyra na fal*. Nuk kuptohet lidhja që ka kjo fjali me atë vijuese apo paraprirëse.
- Esetë vuajnë nga shkrimi rastësor, nga komentet për përvoja personale apo të dëgjua nga të tjerët dhe mungon prirja drejt parashtrimit të tezave, fakteve, argumenteve e kundërarargumenteve.
- Tendencë për të shkruar me një stil karakteristik të ligjërit gojor, bën që të humbë logjika e frazës dhe maturanti të bëjë edhe gabime gramatikore, siç është përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën: *Pa liri e gjithë bota shndërrohet në ferr kaotik ku errësira e pushtetit të dhunshëm, padrejtësive dhe vuajtjeve të njerëzve të ndershëm bëhen errësira e natës*.
 - ✓ Në fjalinë *Ne jo perfeksionitët, në pikëzat e vdekshme zëmë një vend tonin në gjithë këtë larmi pikëzash...*, kumtimi nuk është i qartë, krijohet një kakofoni e panevojshme.
 - ✓ Në fjalinë: *Fjala thyen gurin, ...të jep dije, të jep injorancë*, bëhen deklarata jologjike, që kundërshtojnë njëra-tjetrën me anë të antonimeve të prira nga e njëjta folje.
 - ✓ Jep një pjesë të nënrenditur të qëndrojnë si e pavarur: *Kur arrestohet dhe akuzohet për diçka që as ai vet nuk e di*.
 - ✓ Fjalja *Ai nuk vrau dot atë që ishte brenda tij, ai vrau gabimet e tij, ai përmirësoi në mjeshtërinë e krimit*, nuk arrin të kumtojë atë çfarë ka pasur në mendje autor/i,-ja (ai vrau gabimet e tij, ai përmirësoi në mjeshtërinë e krimit).
 - ✓ *Kjo na vendos përballë një dileme të vështirë, një zgjedhje; të dalësh kundër shoqërisë apo edhe komplekseve vetjake duke rrëzuar tabu, e rrezikuar lumturinë në komunitetin ku jeton, apo të vetësakrifikosh këtë pozitë në shoqëri e të zgjedhësh një tjetër lumturi, atë më realen, më personalen e të ngushtë lumturinë e vërtetë që lind prej dashurisë.*, ku mendimi nuk del i qartë.
 - ✓ Vazhdim mendimi në formë tërkuze, me zgjatje narracioni: *Dhe ja kur vjen një ditë që në mënyrë krejt absurde ai përgatitet qetësisht të presë fundin e tij*,

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHTETËRORE

një fund i paracaktuar që në fillim dhe gjatë kësaj periudhe na vjen edhe më tragjike mosrezistenca dhe nënshtrimi i personazhit.

- Në ese gjen shumë gabime drejtshkrimi e pikësimi (presja, -ë fundore dhe në pozicione të tjera brenda fjalës, apostrofi, trajtat e shkurtra të bashkuara; diftongjet; i/j; bashkëtingëlloret e zëshme e të pazëshme r/rr, ll/dh, t/d, p/b; ç/q, q/gj; parashitesat fjalëformuese pa-, mos-, s/z, xh/zh,ç/sh; grupet e bashkëtingëlloreve nd, mb, ngj etj.: *e bënë* (duhet pa *ë* fundore); *haresës* (duhet *harresës*; *do të ndodh* (duhet me *ë* fundore); *kqyr* (duhet *këqyr*); *tja* (duhet *t'ia*); *djell* (duhet *diell*); *vjete* (duhet *vjet*); *e pa zëvendësueshme* (duhet *e pazëvendësueshme*); *e pa prekshme* (duhet *e paprekshme*); *E bënë të ndal* (duhet *e bën të ndalë*); *shpejtë* (duhet *shpejt*) etj., *ambicjen*; ...*tri magjistareve me anën e së cilave...*; *me të vërtet*; *thëriti*; *pa ju dridhur qerpiku*; *vrau ëndrat*; *të vras dhe të mos i shpëtoj askush*; *Askush nuk arrin ta shpjegoj*; *vetvritet*.
- Esetë kanë probleme gjuhësore:
 - ✓ Shkruhet me fjali shumë të gjata. Kjo bën që fjalia të mos dalë e qartë në kuptimin që do të përcjellë. P.sh.: ***Kjo është një dëshirë që më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës sime dhe shpesh herë e kam ndjerë si një nevojë dhe një detyrë ndaj asaj, që gjatë gjithë këtyre viteve në mënyrë të vazhdueshme, duke u vetësakrifikuar dhe pa pritur asgjë në këmbim më ka ndihmuar duke menduar gjithmonë për më të mirën për mua dhe pjesën tjetër të familjes.; Ti zonjë shtyve jetën tënde në imazhin e tri magjistareve me anën e së cilave e fundose Makbethin në lumenj gjaku por me të vërtet Makbethi nuk thëriti arsyen por dinjitetin e vrarë, thëriti frikën, u bë pjesë e saj u bë pjesë e një pylli të dendur nga i cili donte të shpëtonte me çdo kusht por nuk e shpëtonte askush, dora që u zgjat për ta ndihmuar ishte vetëm dora e zonjës Makbeth.***
 - ✓ Ka disa probleme me ndërtimin e fjalive, sidomos fjalive të shkurtra. Përgjithësisht përdoren fjali të thjeshta, gjë që bën të mendosh se maturanti ende nuk e zotëron plotësisht aftësinë e të shkruarit.
 - ✓ Ngatërrohen kohët e foljeve: e tashmja përdoret për të shkuarën e anasjelltas.
 - ✓ Përdoren fjalë të huaja.
- Maturantët nuk janë në gjendje të redaktojnë esenë. Maturanti shkruan pa bërë paraprakisht redaktim në kokën ti, por as në fund nuk rikthehet për të redaktuar esenë. Për rrjedhojë: Eseja është e ngarkuar me fjali përshkruese dhe ka përsëritje mendimesh. Eseja nuk ndjek një vijimësi logjike e kronologjike. Ka përsëritje të fjalëve e fjalive. P.sh., mbiemri “i ndryshëm”, brenda fjalisë së dytë është përdorur katër herë; brenda paragrafit pesë herë, kurse ndajfolja “ndryshe” dy herë. Fjalitë fillojnë me parafjalë, përemër ose me lidhëz: *Por njeriu...*; *Por në rrezet...* Tri fjali të njëpasnjëshme me të njëjtin fillim (*Ai është... Ai akuzohet... Ai është...*). Dy të tjera me “ata”: *Ata të dy... Ata njësoj...* Dy fjali fillojnë me “dhe” (*Dhe kur i vret... Dhe në fund...*). *Dhe gjithë kjo...*

3. PSE MATURANTËT NUK ARRIJNË REZULTATE TË KËNAQSHME NË ESE NË PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE?

Problemet e hasura deri tani në ese gjatë provimit të Maturës Shtetërore, i përkasin pjesërisht edhe faktit që këto matura janë përgatitur me një kurrikul shumë të centralizuar, e cila ishte e përqendruar të dija dhe jo tek aftësitë e nxënësve. Programi i letërsisë, pavarësisht se në maturë është trajtuar si gjuhë shqipe dhe letërsi (apo letërsi dhe gjuhë shqipe), në fakt kishte shumë mangësi në formimin eseistik të nxënësve. Programet mësimore (jo vetëm të gjuhës shqipe dhe letërsisë) dhe puna e mësuesve, deri tani, nuk kanë arritur t'u japin maturantëve formimin e mjaftueshëm për konceptin mbi esenë, për llojet e esesë, për teknikën si shkruhet një ese. Tekstet shkollore dhe mësuesit kanë përcjellë të nxënësit informacion të pamjaftueshëm për esenë si forma më e lartë e të shprehurit letrar e filozofik dhe e të shkruarit nga këndvështrimi personal.

Maturantët, nisur dhe nga lënda të cilën e japin provim, nuk sjellin, nuk përdorin, nuk analizojnë, nuk gjykojnë dhe nuk vlerësojnë në ese argumente, shembuj, ngjarje, fakte, shkaqe e pasoja nga fusha të tjera të dijes: nga historia, nga sociologjia, nga shkencat e natyrës, nga artet etj. Këtë, ndoshta, ua kufizon lënda e provimit (Gjuhë shqipe dhe letërsi) dhe formulimi i temës për ese.

Maturantët përpiqen të "tregojnë" vetëm sa "letrarë" ("shkrimtarë") janë, sa e njohin personazhin apo subjektin e veprës artistike, ndaj shkruajnë komente, nuk dalin me një tezë të tyren, me argumente që ta mbrojnë atë, sidomos në paragrafët e trungut, dhe nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur mbylljes.

Në ese, maturantët nuk "filozofojnë", por, edhe kur e bëjnë këtë, nuk arrijnë të jenë vetvetja. I shqetëson fakti se si mund të paraqesin një ese të mirë, por ata nuk janë të qartë se çfarë presin vlerësuesit prej tyre.

Maturantët nuk kanë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për të shkruar e rishkruar esenë në provimin e Maturës Shtetërore.

Shumë maturantë nuk punojnë fare për esenë gjatë provimit të Maturës Shtetërore, e lënë faqen plotësisht të bardhë. Kjo ndodh ngaqë ata nuk e ndiejnë veten të aftë për të krijuar (se, siç shënuam më sipër, esenë e vlerësojnë vetëm si krijim), por nisen dhe nga mendimi se u mjaftojnë pikët që mund të sigurojnë nga përgjigjet në pyetjet e tjera të testit. Në provimin e Maturës Shtetërore 2008, mbi 45% e maturantëve të drejtimit shoqëror dhe të përgjithshëm nuk fituan asnjë pikë në ese, po kështu dhe mbi 67% e maturantëve të seksionit dygjuhësh.

4. PROBLEME QË KËRKOJNË VËMENDJE

4.1. Parapërgatitja e maturantit për të menaxhuar kërkesat e testit dhe kohën fizike që ka ditën e provimit të detyruar të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Shkolla, mbështetur në urdhrin dhe në rregulloren e MASH-it për Maturën Shtetërore, informon në kohë maturantin për datat e provimeve, për procedurat dhe rregullat gjatë çdo provimi. Maturanti ndihmohet nga programi orientues i lëndës, në të cilin mbështeten edhe hartuesit e testit.

Realisht, asnjë maturant nuk udhëzohet dhe nuk instruktohet për teknikën më të efektshme që ai duhet të ndjekë kur ulet në sallë për të plotësuar testin e Maturës Shtetërore. Çdo maturant, veçanërisht në prag të sesionit të provimeve, bën sprovë për të shkruar modele të ndryshme testesh të Maturës Shtetërore, por këto sprovë nuk "kronometrohen". Kështu maturanti vetëm "provon" veten sa i

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHETËTËRORE

zoti është, por ai nuk aftësohet të menaxhojë kërkesat e testit dhe kohën fizike në ditën e provimit.

Në vend që puna përgatitore për provimin e detyruar të ketë shtrirje gjithëvjetore, parapërgatitja e maturanëve zakonisht bëhet në muajt e fundit të maturës, me anë të punimit të testeve të ndryshme të viteve të mëparshme, duke dhënë udhëzimet përkatëse për mënyrën e menaxhimit të kërkesave dhe të kohës në dispozicion. Nxënësi duhet të shikojë testin në tërësi, për ta menaxhuar me sukses atë; të përqendrohet në kërkesat e pyetjeve; të fillojë me përgjigjet e pyetjeve që di të zgjidhë e deri tek eseja, që është në fund.

4.2. Angazhimi i nxënësit për të fituar kompetenca për të shkruar ese. Mësuesit dhe specialistë të arsimit vënë theksin në rëndësinë që ka angazhimi i nxënësit për të shkruar ese. Ata kërkojnë angazhim maksimal të nxënësit dhe këtë e vlerësojnë si primar jo vetëm për arritjen e suksesit në Maturën Shtetërore, por dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor në tërësi. Sugjerohet që nxënësi të ushtrohet vetë dhe të ketë besim se me hapa të ngadaltë, por sistematikë, duke shkruar çdo ditë e me këmbëngulje, do të arrijë rezultatet e dëshiruara. Por jo pak mësues e specialistë e kanë shqetësim të madh përfshirjen e nxënësve. Ashtu si për shumë veprimtari të tjera mësimore, nxënësit nuk e kanë me shumë qejf edhe esenë. Ata ndiejnë vështirësi, sepse eseja kërkon kohë dhe mund, ndërkohë që ata parapëlqejnë që “me sa më pak punë, të arrijmë rezultate të larta”.

4.3. Roli i mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Eseja po praktikohet në lëndë të ndryshme mësimore, por me shumë mangësi, sepse mësuesit nuk e kanë pasur esenë pjesë të formimit të tyre profesional. Rol i veçantë dhe i padiskutueshëm i takon mësuesit të gjuhës shqipe dhe letërsisë për sa i përket punës me esenë. Në programin e vjetër të gjimnazit eseja nuk zinte një pjesë të konsiderueshme në të, ndërsa te kurrikula e re ajo zë 60% të formimit gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mendoj të theksoj disa momente:

Së pari, vërehet se shumë mësues, sidomos ata me përvojë, e kanë ende të vështirë të shkëputen nga koncepti i esesë i lidhur me hartimin, kërkojnë ende fjalë të bukura, përdorim metaforik dhe figuracion, pas të cilit mund të fshihet edhe mungesa e mendimit deri edhe të humbë koncepti ese, duke kaluar ndonjëherë edhe në fletë ditari apo përjetime boshe që nuk thonë asgjë.

Së dyti, edhe tek mësues me përvojë mungon kultura e duhur dhe formimi i duhur, pasi ata nuk lexojnë, ose nuk nxiten për të lexuar apo për t’u formuar profesionalisht në vazhdimësi.

Së treti, një numër i madh botimesh (përfshirë edhe botime që trajtojnë çështjet e esesë) dhe udhëzuesish ndonjëherë janë edhe kaotikë. Ka edhe libra për mësuesit që jo gjithmonë pasqyrojnë trajtime shkencore dhe të vlefshme.

Së katërti, në klasë eseja ende shihet si produkt dhe jo si proces. Mësuesit nuk ua lënë nxënësve detyrë shtëpie esenë, nga frika se mund t’ua bëjë dikush tjetër, kurse në klasë eseja nuk trajtohet sa duhet. Ende mësuesi koncepton shkollën dhe procesin mësimor të mbështetur te përmbajtja dhe jo tek objektivat. Pothuaj të gjithë mësuesit janë të përfshirë nga ethet se çfarë t’u mësojnë nxënësve.

Së pesti, mësuesit nuk përballojnë korrigjimin apo vlerësimin e esesë në mënyrë korrekte dhe sistematike, sepse ata janë të ngarkuar në punë, kriteret nuk mund i shpëtojnë subjektivitetit, nxënësit kanë prirje për të kopjuar, në vend që të shpenzojnë kohë dhe punë.

Së gjashti, mësuesit mbeten brenda skemave që u ofrohen si modele, pa kërkuar nga nxënësit stili dhe origjinalitet.

4.4. Formulimi i temave të esëve në testin e Maturës Shtetërore.

Temat e esëve që jepen në provimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, edhe kur kërkojnë argumentime, përshkrime, krahasime etj., u kushtohen fakteve e ngjarjeve të fragmentit që përfshihet në test, apo të një vepre letrare; japin edhe shkaku, edhe pasojën (P.sh.: 1. *Vetëm dashuria mund të shkrijë akujt e shpirtit*. Nisur nga konteksti i novelës, argumento vlerën e këtij pohimi. - M. Camaj: “Rrunggaja në mars”; 2. Balzaku ka thënë: “Për mua, elementi bazë i shoqërisë nuk është individi, por familja” dhe këtë e realizon në vepër kur thotë: “...të gjitha do të shemben, nëse fëmijët nuk i duan prindërit e tyre...”. Argumento mendimin tënd lidhur me këtë pohim në formën e një eseje. - Balzak: “Xha Gorio”).

Temat e esëve, në mjaft raste, nga mënyra si janë formuluar, e “shterojnë” mendimin, e kufizojnë dhe e ngushtojnë rrezen e “filozofimit” që duhet të bëjë maturanti (P.sh.: 1. “Ajo që qeveris botën, nuk është as forca, as ligji, por urtia.” A je dakord me këtë pohim? Pse? Argumento mendimin tënd. - P. Marko: “Qyteti i fundit”. 2. Mesazhi i poemës është se jeta i ngjan një ëndrrë të shkurtër e shpesh drithëronjëse, por, megjithatë, ia vlen ta jetojmë e ta gëzojmë. Duke patur parasysh këtë fragment dhe poemën në tërësi, vazhdoje këtë ide sipas mendimit tënd. - N. Mjeda: “Andrra e jetës”).

Tema e esesë “kapet” kryesisht pas një detaji të fragmentit që është futur në test. Maturanti, veçanërisht ai që nuk e ka lexuar dhe nuk e njeh veprën e plotë (të tillë kemi shumë nxënës në shkollat e mesme profesionale, por dhe në gjimnaz), nuk arrin të dalë jashtë fragmentit. Në këto kushte, maturanti sillet e sillet rreth titullit; shtjell e pështjell fjalët që përmban titulli, duke i shkruar e rishkruar ato, ose, nëse gjen momentin; nis e shkruan për veten, për çfarë mund t’i ketë ndodhur atij, një të afërmi apo një shoku a shoqeje të tij; shkruan për çfarë nuk dëshiron t’i ndodhë atij e askujt, ose shkruan për histori e ndodhi, nganjëherë të sajua. Rasti i fundit është për t’u vlerësuar, por maturanti nuk arrin të bindë lexuesin (vlerësuesin) me aq sa arrin të sajohet dhe me aq sa shkruan e si shkruan.

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Provimet e Maturës Shtetërore janë provime kombëtare dhe kryhen sipas procedurave dhe rregullave të njëjta për të gjithë kandidatët. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, institucion vartës i saj, realizojnë hartimin e zgjedhjen e testeve, vlerësimin e tyre dhe pranimin e aplikantëve në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë sipas parimit Meritë-Preferencë.

2. Në testin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, eseja, zakonisht, është kërkesa e renditur e fundit. Ajo përbën një peshë të konsiderueshme në rezultatin që mund të arrijë maturanti. Në rastin më të mirë, kur eseja e shkruar nga maturanti vlerësohet

QASJE VLERËSUESE PËR ESENË E MATURËS SHTETËRORE

me 8 pikë, i siguron atij 16% të vlerësimit maksimal në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë.

3. Në qendrat e vlerësimit të testeve të Maturës Shtetërore aktivizohen mësues ndër më të kualifikuarit e lëndës. Megjithatë, vlerësimi i esesë mbetet pika më e dobët e më e diskutueshme, për shkak të subjektivitetit të vlerësuesve, pasi ata nuk kanë përpara kritere specifike, të cilave duhet t'u përmbahen me përpikëri gjatë vlerësimit të esesë.

4. Esetë e nxënësve kanë mangësi në strukturë, në mënyrat e organizimit të esesë, dhe në përmbajtje, në sjelljen e argumenteve objektive e subjektive, të dhënave, citimeve etj. Ato vuajnë nga gjuha dhe fjalori i varfër, nga mungesa e stilit origjinal, nga sintaksa e dobët dhe gabimet drejtshkimore e të pikësimit.

5. Arritjet jo të kënaqshme në ese, nga shumë mësues u faturohen nxënësve. Pa shmangur rolin e shkollës dhe të mësuesit për parapërgatitjen e maturantëve për esenë, ende ka vështirësi të mëdha, që duhen kapërcyer. Mendoj se mangësitë, në radhë të parë, duhen kërkuar:

- Tek teksti mësimor (libri i nxënësit) që është i mbytur me *tekstin joletrar*.
 - Te mësuesi, që zakonisht mbetet brenda skemave që i serviren si modele. Shumë mësues ende konceptin e esesë e lidhin me hartimin. Koncepti për esenë dhe didaktika e mësimit të esesë duhet të bëhen pjesë e kualifikimeve dhe e vlerësimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
 - Te parapërgatitja e maturantit për të shkruar ese dhe për të menaxhuar kërkesat e testit dhe kohën fizike që ka ditën e provimit të detyruar të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
 - Te formulimi i temës për ese që shpesh ua kufizon maturantëve hapësirën që ata të sjellin, të përdorin, të analizojnë, të gjykojnë dhe të vlerësojnë në ese argumente, shembuj, ngjarje, fakte, shkaqe e pasoja nga fusha të tjera të dijës: nga historia, nga sociologjia, nga shkencat e natyrës, nga artet etj.
6. Gjatësia e esesë, sasia e fjalëve të saj, në testin e Maturës Shtetërore nuk është kriter. Mendoj se përcaktimi i një dyshemeje dhe i një tavani fjalësh që duhet të përmbajë një ese, u duhet mësuar nxënësve dhe duhet kërkuar edhe në provim. Kjo do të shpinte edhe në një vlerësim shumë më korrekt e më objektiv.
7. Temat e eseve që jepen në provimin e detyruar të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, u kushtohen fakteve e ngjarjeve të fragmentit që përfshihet në test, apo të një vepre letrare; e “shterojnë” mendimin, e kufizojnë dhe e ngushtojnë rrezen e “filozofimit” që duhet të bëjë maturanti; “kapen” kryesisht pas një detaji të fragmentit që është futur në test.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
F. Alastair, *How to write*, Oxford University Press, 2006.
B. Rama, *Maturant, eja në ese...*, Emal, Tiranë, 2012.
K. Dibra, N. Varfi, *Gjuhësi teksti*, ShB “Albatros”.
M. Lerner, *Writing smart: Your guide to great writing*, Random House, 2001.

BESNIK RAMA

Programi i lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” për klasën e 10-të, 2008, të 11-të dhe të 12-të, 2010.

Programi i lëndës së letërsisë për klasën e 12-të, prill 2010.

Programi orientues për provimin e detyruar të Maturës Shtetërore, lënda “Gjuhë shqipe dhe letërsi” (gjimnaz), viti shkollor 2011-2012.

Programi orientues për provimin e letërsisë së thelluar (provim me zgjedhje - gjimnaz dhe gjimnaz gjuhësor), viti shkollor 2011-2012.

Raporte - Matura Shtetërore 2008, Tiranë, 2009.

Raporte - Matura Shtetërore 2009, Tiranë, 2010.

BURIME NGA INTERNETI

<http://www.mash.gov.al> “Matura Shtetërore”